



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. D.P
 Dep. _____
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica _____
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. 03-3469/10
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 19.10.2010
 Date _____



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16943/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Ilirjana Zymberaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik Ligji nr.03/L-151, e në bazë të nenit 73,74,195,199 të LMK-ës, me datën 06.09.2010, merrë këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Ilirjana Zenun Zymberaj e lindur më 23.01.1963 në Shushicë Komuna e Istogut, jeton në Prishtinë lagja Kodra e diellit rr. Afrim Zhitija Bll. 1 hyrja 4 nr.8, kryeinspektore sanitare e Kosovës, punëtoare në Agjencionit të ushqimit dhe veterinerisë në zyrën e kryeministrit, e martuar nënë e tre fëmijëve, Mr. e teknologjisë ushqimore, e gjendjes mesatare ekonomike, deri më tani thot jo e denuar.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse si zyrtare e lartë publik nuk e ka deklaruar Agjencionit kundër korrupsionit në Prishtinë pasurinë për vitin 2009 në afatin ligjor deri më dt.31.03.2010. Me veprim të tillë ka kryer kundërvajtje nga neni 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik Ligji nr.03/L-151. Andaj për këtë:

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej:800 (Tetëqind)Euro.
 Gjobën e shqiptuar e pandehura është e obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë në favor të AQF i Drejtësisë në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-70000515.
 Po qe se brenda afatit të caktuar e pandehura nuk e paguan gjobën e njejta do ti zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (Tridhjet ditësh), duke llogaritur 15(pesëmbëdhjetë)euro në një ditë burgimi.
 Në emër të paushallit e pandehura është e obliguar të paguaj shumën prej 5(pesë) Euro në afat të njejtë sikurse gjobën në të njejtën llogari rrjedhëse.
 Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr.01/2319/10 të dt.11.06..2010 ,për ndërmarrjen e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurës dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja inicioi procedurën kundërvajtëse u muar në pyetje e pandehura e lartëshenuar e cila në mbrojtjen e vet deklaroi: Është e vërtetë se që Agjencionit kundër korrupsionit nuk e ka deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor deri më 31.03.2010, për shkak se në atë kohë ka pasur angazhime të shumta, komplet drejtoria ka kalu nga një institucion në tjetrin. Çdo vit agjencionit të cekur më lartë që i ka lajmëru pasurinë edhe këtë vit e kishte deklaruar të njejtën, sepse nga viti i kaluar nuk ka ndonjë ndryshim. Deri te kjo ka ardhur vetëm për shkak të angazhimeve të mëdha, një arsye tjetër që nuk e ka pas..

Me kërkesën e ushtruar, marrjen në pyetje të pandehurës, si dhe provat e prezantuara në lëndë është konstatuar se që e pandehura ka bërë kundërvajtje ashtu siqë edhe e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtoare dhe është denuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK ndaj të pandehurës i shqiptoi gjobën sipas peshës së kundërvajtjes së kryer, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit te e pandehura mund të arrihet efekti i sanksionimit që e pandehura në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në diapozitiv të këti aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njejtit dhe pa taksë.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Më.06.09.2010

GJYQTARJA

Melihate Devexhi

